SONY

4-476-203-**41**(1) (AL)

Luajtës Blu-ray Disc™ / DVD

Udhëzimet e përdorimit

Faleminderit për blerjen tuaj. Përpara se ta përdorni këtë luajtës, lexoni me kujdes këto udhëzime.

Fillimi

Riprodhimi

Interneti

Cilësimet dhe përshtatjet

Informacioni shtesë

Blu-ray Disc™

BDP-S1200/BDP-S3200/BDP-S4200/BDP-S5200

PARALAJMËRIM

Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit ose të goditjeve elektrike, kjo pajisje nuk duhet të ekspozohet ndaj pikimeve ose spërkatjeve dhe nuk duhen vendosur objekte të mbushura me lëngje, si p.sh. vazo mbi pajisje.

Për të shmangur goditjen elektrike, mos e hapni kasën e pajisjes. Për shërbimet drejtojuni vetëm personelit të kualifikuar.

Kordoni elektrik duhet të zëvendësohet vetëm në dyqane të kualifikuara servisi.

Mos i ekspozoni bateritë ose pajisjet me bateri të instaluara ndaj nxehtësisë së tepruar si p.sh. drita e diellit dhe zjarri.

KUJDES

Përdorimi i instrumenteve optike me këtë produkt do të rrisë rrezikun ndaj syve. Duke qenë se rrezja e lazerit të përdorur në këtë luajtës Blu-ray Disc/DVD është e dëmshme për sytë, mos u përpiqni të çmontoni mobilien.
Për shërbimet drejtojuni vetëm personelit të kualifikuar.

CAUTION CLASS 3R VISIBLE AND INVISIBLE LASER RADIATION WHEN OPEN. AVOID DIRECT EYE EXPOSURE.
VORSICHT KLASSE 3R SICHTBARE UND UNSICHTBARE LASERSTRAHLUNG WENN GEÖFFNET. UNMITTELBAREN AUGENKONTAKT VERMEIDEN.
ADVARSEL SYNLIG OG USYNLIG LASERSTRÅLING AF KLASSE 3R VED ÅBNING. UNGÅ AT SE DIREKTE PÅ STRÅLEN.
ADVARSEL SYNLIG OG USYNLIG LASERSTRÅLING I KLASSE 3R NÅR DEKSEL ÅPNES. UNNGÅ DIREKTE EKSPONERING AV ØYNENE.
VARNING KLASS 3R SYNLIG OCH OSYNLIG LASERSTRÅLNING NÄR DENNA DEL ÄR ÖPPNAD. UNDVIK ATT DIREKT EXPONERA ÖGONEN FÖR STRÅLNINGEN.
VARO! AVATTUNA LUOKAN 3R NÄKYVÄÄ JA NÄKYMÄTÖNTÄ LASERSÄTEILYÄ. VÄLTÄ KATSEEN SUORAA ALTISTAMISTA.
警告 打开时有3R类可见和不可见激光辐射，避免眼睛受到直射的照射
注意 打開時有第3R類可視及不可視雷射輻射，避免眼睛直接暴露。

Kjo etiketë ndodhet mbi kapakun mbrojtës të lazerit brenda pajisjes.

CLASS 1 LASER PRODUCT
LASER KLASSE 1
LUOKAN 1 LASERLAITE
KLASS 1 LASERAPPARAT
1类激光产品
第1類雷射產品

Kjo pajisje klasifikohet si produkt LAZER KLASI 1. Shenja PRODUKT LAZER KLASI 1 ndodhet në pjesën e jashtme të pasme.

Hedhja e pajisjeve të vjetra elektrike dhe elektronike (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe shtetet e tjera evropiane me sistem të diferencuar grumbullimi)

Ky simbol mbi produkt ose mbi paketimin e tij tregon se ky produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Përkundrazi, do të dorëzohet pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike. Duke u siguruar që ky produkt të hidhet siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin, që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të këtij produkti. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore. Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Vetëm për Evropën

Hedhja e baterive të përdorura (e aplikueshme në Bashkimin Evropian dhe vendet e tjera evropiane me sisteme të diferencuara grumbullimi)

Ky simbol mbi bateri ose mbi paketim tregon se bateria e dhënë me këtë produkt nuk duhet të trajtohet si mbeturinë shtëpiake. Në disa bateri, ky simbol mund të përdoret i kombinuar me një simbol kimik. Simbolet kimike për zhivën (Hg) ose plumbin (Pb) shtohen nëse bateria përmban më shumë se 0.0005% zhivë ose 0.004% plumb. Duke u siguruar që këto bateri të hidhen siç duhet, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative për mjedisin dhe shëndetin që në rast të kundërt do të shkaktoheshin nga trajtimi i papërshtatshëm i mbetjeve të kësaj baterie. Riciklimi i materialeve do të ndihmojë në ruajtjen e burimeve natyrore.

Në rast produktesh të cilat për arsye sigurie, rendimenti apo integriteti të dhënash kërkojnë lidhje të qëndrueshme me një bateri të inkorporuar, kjo bateri duhet të zëvendësohet vetëm nga personel i kualifikuar shërbimi. Për të siguruar trajtimin e duhur të baterisë, dorëzojeni produktin në fund të periudhës së funksionimit të tij pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike.

Për të gjitha bateritë e tjera, ju lutemi shihni pjesën që flet mbi heqjen e sigurt të baterisë nga produkti. Dorëzojeni baterinë pranë pikës përkatëse të grumbullimit për riciklimin e baterive të përdorura.

Për më shumë informacion të detajuar mbi riciklimin e këtij produkti ose baterie, ju lutemi kontaktoni me bashkinë tuaj, shërbimin e grumbullimit të mbeturinave shtëpiake ose dyqanin ku keni blerë produktin.

Ky produkt është prodhuar nga ose për llogari të Sony Corporation, 1-7-1 Konan Minato-ku Tokyo, 108-0075 Japoni. Pyetjet në lidhje me pajtueshmërinë e produktit sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian do t'i adresohen përfaqësuesit të autorizuar, Sony Deutschland GmbH, Hedelfinger Strasse 61, 70327 Stuttgart, Gjermani. Për çdo çështje shërbimi ose garancie, drejtojuni adresave që jepen në dokumentet e posaçme të shërbimit ose të garancisë.

Masat paraprake

- Kjo njësi punon me 220 V - 240 V AC, 50/60 Hz. Kontrolloni që tensioni i përdorimit të njësisë të jetë identik me furnizimin vendas me energji.
- Instalojeni këtë njësi në mënyrë që kablloja e rrjetit elektrik të mund të shkëputet nga priza e murit menjëherë në rast problemi.

Masat paraprake

Kjo pajisje është testuar dhe është gjendur konform limiteve të përcaktuara në Direktivën EMC për përdorimin e një kablloje lidhëse më të shkurtër se 3 metra.

Mbi vendosjen

- Vendoseni luajtësin në një vend me ajrosje të përshtatshme për të parandaluar grumbullimin e nxehtësisë te luajtësi.
- Për të zvogëluar rrezikun e zjarrit, mos e mbuloni hapësirën e ajrimit të pajisjes me gazeta, mbulesa tavoline, perde etj.
- Mos e ekspozoni pajisjen ndaj burimeve me flakë të zbuluar (për shembull qirinj të ndezur).
- Mos e instaloni këtë luajtës në një hapësirë të kufizuar, si në një raft librash ose në një njësi të ngjashme.
- Mos e vendosni luajtësin jashtë, në automjete, në anije ose në mjete të tjera.
- Nëse luajtësi sillet menjëherë nga vend i ftohtë në vend të ngrohtë ose mbahet në dhomë me shumë të lagështi, mund të ndodhë kondensim i lenteve nga brenda. Nëse ndodh kjo, luajtësi mund të mos punojë siç duhet. Në këtë rast, hiqni diskun dhe lëreni luajtësin të ndezur për rreth gjysmë ore derisa të avullojë lagështira.
- Mos e instaloni luajtësin në një pozicion të pjerrët. Ai është projektuar që të përdoret vetëm në pozicion horizontal.
- Mos vendosni objekte metalike përpara panelit të përparmë. Kjo mund të kufizojë marrjen e valëve të radios.
- Mos e vendosni luajtësin në një vend ku janë në përdorim pajisje mjekësore. Kjo mund të shkaktojë keqfunksionim të instrumenteve mjekësore.
- Nëse përdorni një stimulator kardiak ose pajisje tjetër mjekësore, konsultohuni me mjekun ose prodhuesin e pajisjes mjekësore përpara se të përdorni funksionin LAN me valë.
- Ky luajtës duhet të instalohet dhe përdoret me një distancë minimale prej të paktën 20 cm ose më shumë mes luajtësit dhe trupit të personit (duke përjashtuar ekstremet trupore: duart dhe kyçet e tyre, këmbët dhe kyçet e tyre).
- Mos vendosni objekte të rënda ose të paqëndrueshme mbi luajtës.
- Mos vendosni objekte të tjera përveç disqeve në sirtarin e diskut. Kjo mund të shkaktojë dëmtime te luajtësi ose objekti.
- Kur zhvendosni luajtësin, nxirrni diskun që mund të ketë brenda në sirtarin e diskut. Nëse nuk e bëni këtë, disku mund të dëmtohet.
- Shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) dhe kabllo të tjera nga luajtësi kur e zhvendosni luajtësin.

Mbi burimet e rrymës

- Luajtësi nuk hiqet nga burimi i rrymës (rrjetit elektrik) për sa kohë që është e lidhur me prizën, edhe nëse luajtësi vetë është i fikur.
- Nëse nuk do ta përdorni luajtësin për një kohë të gjatë, shkëputeni luajtësin nga priza e murit. Për të shkëputur kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik), kapeni te vetë priza; mos tërhiqni asnjëherë kordonin.
- Ndiqni pikat e mëposhtme për të parandaluar dëmtimin e kordonit të rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik). Mos përdorni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) nëse është i dëmtuar, duke qenë se kjo mund të rezultojë në goditje elektrike ose zjarr.
  - Mos e përthyeni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) mes luajtësit dhe murit, raftit, etj.
  - Mos vendosni objekte të rënda mbi kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) dhe mos ushtroni forcë mbi vetë kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik).

Mbi ushqyesin

- Për luajtësin përdorni ushqyesin e dhënë, pasi ushqyes të tjerë mund të shkaktojnë defekt.
- Mos e zbërtheni dhe mos e çmontoni për qëllime dublikimi.
- Mos e kufizoni luajtësin në vende të ngushta, si rafte librash apo të ngjashme.
- Mos e lidhni ushqyesin në elektrotransformator portativ, pasi mund të prodhojë nxehtësi dhe të shkaktojë defekt.
- Mos e rrëzoni dhe mos e godisni.

Mbi rregullimin e volumit

Mos e ngrini volumin ndërkohë që dëgjoni një pjesë me hyrje në nivele shumë të ulëta ose pa sinjale audio. Veshët tuaj dhe altoparlantët mund të dëmtohen kur niveli i zërit arrin nivel maksimal të lartë.

Mbi pastrimin

Pastroni kabinetin, panelin dhe kontrollet me një copë të butë. Mos përdorni asnjë lloj pastruesi abraziv, tela fërkimi ose tretës si alkooli ose benzina.

Mbi pastrimin e disqeve, pastruesit e disqeve/lenteve

Mos përdorni disqe pastruese ose pastrues disqesh/lentesh (duke përfshirë llojet e lëngshme ose me spërkatje). Këto mund të shkaktojnë keqfunksionim të aparaturës.

Mbi zëvendësimin e pjesëve

Në rast se ky luajtës riparohet, pjesët e riparuara mund të mblidhen për ripërdorim ose për riciklim.

Lidhja me folenë HDMI OUT

Ndiqni pikat e mëposhtme duke qenë se trajtimi i pasaktë mund të dëmtojë folenë dhe konektorin HDMI OUT.

- Vendosni saktë me kujdes folenë HDMI OUT në pjesën e pasme të luajtësit dhe konektorin HDMI duke kontrolluar format e tyre. Sigurohuni që konektori të mos jetë me kokë poshtë ose i përthyer.



- Sigurohuni të shkëputni kabllon HDMI kur zhvendosni luajtësin.



- Mbajeni drejt konektorin HDMI kur lidhni ose shkëputni kabllon HDMI. Konektorin HDMI mos e përthyeni dhe as mos e fusni me forcë në folenë HDMI OUT.

Për shikimin e pamjeve video 3D (vetëm BDP-S4200/S5200)

Disa persona mund të vuajnë nga shqetësime (si p.sh. lodhje sysh, dobësi ose marrje mendsh) gjatë shikimit të pamjeve 3D. Sony rekomandon që të gjithë shikuesit të bëjnë pushime të rregullta kur shikojnë pamje 3D. Kohëzgjatja dhe frekuenca e pushimeve të nevojshme do të variojë nga personi në person. Duhet të vendosni vetë si është më mirë. Nëse ju shkaktohen shqetësime, duhet të ndërprisni shikimin e pamjeve 3D derisa të mos keni më shqetësime; nëse mendoni se është e nevojshme konsultohuni me mjekun. Duhet të shihni edhe (i) manualin e përdorimit dhe/ose mesazhin e kujdesit të ndonjë pajisjeje tjetër që përdoret me këtë produkt, ose përmbajtjen e Blu-ray Disc që luhet me këtë produkt, si dhe (ii) faqen tonë të internetit (http://www.sony-europe.com/myproduct/) për informacionin më të fundit. Shikimi i fëmijëve të vegjël (sidomos i atyre nën gjashtë vjeç) është ende në zhvillim e sipër. Konsultohuni me mjekun (pediatrin ose okulistin) përpara se të lejoni fëmijët e vegjël të shohin pamje video 3D.
Të rriturit duhet të mbikëqyrin fëmijët e vegjël për të siguruar që ndjekin rekomandimet e renditura më lart.

SHËNIM I RËNDËSISHËM

Kujdes: Ky luajtës është në gjendje të mbajë për një kohë të pacaktuar në ekranin e televizorit një foto ose figurë të palëvizshme video. Nëse lini të shfaqet në televizor foton ose imazhin e palëvizshëm video për një periudhë të tejzgjatur kohore, rrezikoni dëmtimin e përhershëm të ekranit të televizorit tuaj. Të prekshëm nga kjo janë televizorët me ekran plazmë dhe televizorët me ekran me projeksion.

Nëse keni pyetje ose probleme në lidhje me luajtësin tuaj, ju lutemi kontaktoni shitësin më të afërt të Sony.

Mbrojtja kundër kopjimit

Ju lutemi kini parasysh sistemet e përparuara të mbrojtjes së përmbajtjes që përdoren në mjetet e përdorimit të Blu-ray Disc™ dhe DVD. Këto sisteme të quajtura AACS (Advanced Access Content System), në shqip sistem i përmbajtjes së përparuar të aksesit, dhe CSS (Content Scramble System) në shqip sistem i kodimit të përmbajtjes, mund të përmbajnë disa kufizime për riprodhimin, daljen analoge dhe veçori të tjera të ngjashme. Përdorimi i këtij produkti dhe kufizimet e vendosura mund të variojnë në varësi të datës së blerjes, duke qenë se bordi drejtues i AACS mund të miratojë ose ndryshojë rregulloret e veta të kufizimeve pas datës së blerjes.

Njoftim nga Cinavia

Ky produkt përdor teknologji Cinavia për të kufizuar përdorimin e kopjeve të paautorizuara të disa filmave e videove komerciale dhe kolonave të tyre zanore. Kur diktohet përdorimi i ndaluar i një kopjeje të paautorizuar, do të shfaqet një mesazh dhe riprodhimi ose kopjimi do të ndërpritet.

Më shumë informacion mbi teknologjinë Cinavia jepet në Qendrën Online të Cinavia për Konsumatorët në faqen http://www.cinavia.com. Për të kërkuar informacion shtesë mbi Cinavia përmes postës së thjeshtë, dërgoni një kartolinë me adresën tuaj të postës në adresën: Cinavia Consumer Information Center, P.O. Box 86851, San Diego, CA, 92138, USA.

Për manualin

Fotografia e faqes kryesore është BDP-S5200.

E drejta e autorit dhe markat tregtare

- „AVCHD“ dhe logoja „AVCHD 3D/ Progressive“ janë marka tregtare Panasonic Corporation dhe Sony Corporation.
- Java është markë tregtare e Oracle dhe/ose filialeve të saj.
- ⁝⁝, „XMB“, dhe „xross media bar“ janë marka tregtare të Sony Corporation dhe Sony Computer Entertainment Inc.
- Prodhuar me licencë nga Dolby Laboratories. Dolby, Pro Logic dhe simboli me dy „D“ janë marka tregtare të Dolby Laboratories.
- Për patentat DTS, shihni http://patents.dts.com. Prodhuar me licencë nga DTS Licensing Limited. DTS, Simboli dhe DTS e Simboli bashkë janë marka të regjistruara tregtare dhe DTS 2.0+Digital Out është markë tregtare e DTS, Inc. © DTS, Inc. Të gjitha të drejtat të rezervuara.
- Termat HDMI® dhe HDMI High-Definition Multimedia Interface, si dhe logoja HDMI janë marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të HDMI Licensing LLC në Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera.
- Blu-ray Disc™, Blu-ray™, Blu-ray 3D™, BD-Live™, BONUSVIEW™ dhe logot janë marka tregtare të Blu-ray Disc Association.
- „DVD Logo“ është markë tregtare e DVD Format/Logo Licensing Corporation.
- Logot „DVD+RW“, „DVD-RW“, „DVD+R“, „DVD-R“, „DVD VIDEO“ dhe „CD“ janë marka tregtare.
- „BRAVIA“ është markë tregtare e Sony Corporation.
- Patentat dhe teknologjia koduese audio MPEG Layer-3 janë të licencuara nga Fraunhofer IIS dhe Thomson.
- Ky produkt përmban teknologji me pronësi të regjistruar me licencë nga Verance Corporation dhe mbrohet nga patenta e SH.B.A.-së 7,369,677 dhe patenta të tjera të SH.B.A.-së dhe botërore të marra dhe në pritje, si dhe të drejta autori dhe mbrojtje e sekretit tregtar për disa aspekte të kësaj teknologjie. Cinavia është markë tregtare e Verance Corporation. Të drejtat e autorit 2004-2010 Verance Corporation. Të gjitha të drejtat të rezervuara nga Verance. Zbërthimi ose çmontimi për qëllime dublikimi është i ndaluar.

- Windows Media është markë tregtare ose markë tregtare e regjistruar e Microsoft Corporation në Shtetet e Bashkuara dhe/ose vende të tjera. Ky produkt përmban teknologji që janë subjekt i disa të drejtave të pronësisë intelektuale të Microsoft. Ndalohet përdorimi ose shpërndarja e kësaj teknologjie jashtë këtij produkti pa licencën/licencat përkatëse nga Microsoft. Zotëruesit e përmbajtjes përdorin teknologji Microsoft PlayReady™ për aksesimin e përmbajtjes për të mbrojtur pronën e tyre intelektuale, duke përfshirë përmbajtjen e mbrojtur me të drejta autori. Kjo pajisje përdor teknologji PlayReady për të aksesuar përmbajtjen e mbrojtur me PlayReady dhe/ose përmbajtjen e mbrojtur me WMDRM. Nëse pajisja nuk arrin të imponojë siç duhet kufizimet mbi përdorimin e përmbajtjes, zotëruesit e përmbajtjes mund të kërkojnë nga Microsoft që të anulojë mundësinë e pajisjes për të përdorur përmbajtje të mbrojtur me PlayReady. Anulimi nuk duhet të ndikojë në përmbajtjet e pambrojtura ose përmbajtje të mbrojtura nga teknologji të tjera për aksesimin e përmbajtjes. Zotëruesit e përmbajtjes mund t'ju kërkojnë të përditësoni PlayReady për të pasur akses në përmbajtjen e tyre. Nëse nuk pranoni të përditësoni, nuk do të jeni në gjendje të keni akses në përmbajtjen që kërkon përditësimin.
- Teknologjia e njohjes së muzikës dhe videos dhe të dhënave përkatëse ofrohet nga Gracenote®. Gracenote është standard i industrisë në teknologjinë e njohjes së muzikës dhe përçimit të përmbajtjes së lidhur me to. Për më shumë informacion, vizitoni www.gracenote.com. CD, DVD, Blu-ray Disc dhe të dhënat e lidhura muzikore dhe video nga Gracenote, Inc., të drejtat e autorit © 2000 deri më sot Gracenote. Softueri Gracenote, të drejtat e autorit ©2000 deri më sot Gracenote. Një ose më shumë patenta të zotëruara nga Gracenote i aplikohen këtij produkti dhe shërbimi. Shihni faqen e internetit të Gracenote për një listë të pjesshme të patentave të aplikueshme Gracenote. Gracenote, CDDB, MusicID, MediaVOCS, logoja Gracenote dhe lloji i logos, si dhe logoja „Powered by Gracenote“ janë marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të Gracenote në Shtetet e Bashkuara dhe/ose vende të tjera.

gracenote

- Wi-Fi®, Wi-Fi Protected Access® dhe Wi-Fi Alliance® janë marka të regjistruara të Wi-Fi Alliance.
- Wi-Fi CERTIFIED™, WPA™, WPA2™, Wi-Fi Protected Setup™, Miracast™ dhe Wi-Fi CERTIFIED Miracast™ janë marka të Wi-Fi Alliance.
- Logoja Wi-Fi CERTIFIED është shenjë certifikimi e Wi-Fi Alliance.
- Shenja Wi-Fi Protected Setup është shenjë e Wi-Fi Alliance.
- DLNA®, logoja DLNA dhe DLNA CERTIFIED™ janë marka tregtare, marka shërbimi ose marka certifikimi të Digital Living Network Alliance.
- SDK për pajisje Opera® nga Opera Software ASA. Të drejtat e autorit 2002-2012 Opera Software ASA. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

POWERED BY OPERA®

- Të gjitha markat e tjera tregtare janë marka të zotëruesve të tyre përkatës.
- Emrat e sistemeve dhe produkteve të tjera janë në përgjithësi marka tregtare ose marka tregtare të regjistruara të prodhuesve. Markat ™ dhe ® nuk tregohen në këtë dokument.

Marrëveshja e Licencës së Përdoruesit e Gracenote®

Ky aplikacion ose pajisje përmban softuer nga Gracenote, Inc. nga Emeryville, California („Gracenote"). Softueri nga Gracenote („Softueri i Gracenote") mundëson që ky aplikacion të kryejë identifikimin e diskut dhe/ose skedarit dhe të marrë informacion që lidhet me muzikën, duke përfshirë informacionin mbi emrin, artistin, pjesën dhe titullin („Të dhënat e Gracenote") nga serverët online ose databazat e inkorporuara (në mënyrë kolektive të referuar si „Serverët e Gracenote") dhe të kryejë funksione të tjera. Ju mund të përdorni Të dhënat e Gracenote vetëm përmes funksioneve për përdorim nga Përdoruesi të këtij aplikacioni ose pajisjeje.

Ju bini dakord se do të përdorni Të dhënat e Gracenote, Softuerin e Gracenote dhe Serverët e Gracenote vetëm për përdorimin tuaj personal jotregtar. Ju bini dakord të mos caktoni, kopjoni, transferoni ose transmetoni Softuerin e Gracenote ose çdo Të dhënë të Gracenote te një palë e tretë. JU BINI DAKORD TË MOS PËRDORNI OSE SHFRYTËZONI TË DHËNAT E GRACENOTE, SOFTUERIN E GRACENOTE OSE SERVERËT E GRACENOTE PËRVEÇSE SIÇ LEJOHET SHPREHIMISHT KËTU.

Ju bini dakord se licenca juaj joekskluzive për të përdorur Të dhënat e Gracenote, Softuerin e Gracenote dhe Serverët e Gracenote do të ndërpritet në rast se shkelni këto kufizime. Nëse licenca juaj ndërpritet, ju bini dakord të ndërprisni çdo përdorim të Të dhënave të Gracenote, Softuerit të Gracenote dhe Serverëve të Gracenote. Gracenote rezervon të gjitha të drejtat për Të dhënave e Gracenote, Softuerin e Gracenote dhe Serverët e Gracenote, duke përfshirë të gjitha të drejtat e pronësisë. Në asnjë rrethanë nuk do të bëhet përgjegjëse Gracenote për ndonjë pagesë ndaj jush për informacione që ju jepni. Ju bini dakord që Gracenote, Inc. mund të imponojë të drejtat e veta sipas kësaj Marrëveshjeje kundër jush direkt në emër të vet.

Shërbimi i Gracenote kërkon një identifikues unik për të gjurmuar pyetje për qëllime statistikore. Qëllimi i identifikuesit numerik të caktuar në mënyrë të rastësishme bëhet për t'i lejuar shërbimit të Gracenote të numërojë pyetjet pa ditur asgjë mbi identitetin tuaj. Për më shumë informacion, shihni faqen e internetit për Politikën e Privatësisë së Gracenote për shërbimin e Gracenote.

Softueri i Gracenote dhe çdo artikull i Të dhënave të Gracenote licencohen „PA GARANCI". Gracenote nuk jep deklarim apo garanci, të shprehur ose të nënkuptuar, në lidhje me saktësinë e Të dhënave të Gracenote nga Serverët e Gracenote. Gracenote rezervon të drejtën të fshijë të dhëna nga Serverët Gracenote ose të ndryshojë kategoritë e të dhënave për çfarëdo shkak që Gracenote e gjykon të mjaftueshëm. Nuk jepet asnjë garanci se Softueri i Gracenote ose Serverët e Gracenote janë pa gabime ose se funksionimi i Softuerit të Gracenote ose Serverëve të Gracenote do të jetë i pandërprerë. Gracenote nuk është e detyruar t'ju japë lloje të dhënash shtesë ose të përmirësuara ose kategori që Gracenote mund t'i japë në të ardhmen dhe është e lirë të ndërpresë shërbimet e saj në çdo kohë.

GRACENOTE HEQ DORË NGA ÇDO GARANCI TË SHPREHUR OSE TË NËNKUPTUAR, DUKE PËRFSHIRË, POR PA U KUFIZUAR ME, GARANCITË E NËNKUPTUARA TË TREGTUESHMËRISË, PËRSHTATSHMËRINË PËR NJË QËLLIM TË CAKTUAR, TITULL DHE MOS-SHKELJE. GRACENOTE NUK GARANTON REZULTATET QË DO TË PËRFTOHEN NGA PËRDORIMI NGA ANA JUAJ I SOFTUERIT TË GRACENOTE OSE ÇDO SERVERI TË GRACENOTE. GRACENOTE NUK DO TË JETË PËRGJEGJËSE NË ASNJË RAST PËR ASNJË DËMTIM PASUES OSE AKSIDENTAL OSE PËR ASNJË FITIM TË HUMBUR APO TË ARDHURA TË HUMBURA.

© 2000 deri më sot. Gracenote, Inc.

Përmbajtja

2 PARALAJMËRIM
4 Masat paraprake

Fillimi

10 Udhëzuesi i pjesëve dhe i komandave
14 Hapi 1: Lidhja e luajtësit
16 Hapi 2: Përgatitja për lidhjen me rrjetin
16 Hapi 3: Easy Setup (Konfigurimi i lehtë)

Riprodhimi

18 Luajtja e një disku
20 Luajtja nga një pajisje USB
20 Luajtja përmes një rrjeti
23 Opsionet e disponueshme

Internet (vetëm BDP-S3200/S4200/S5200)

25 Shfletimi i faqeve të internetit

Cilësimet dhe përshtatjet

27 Përdorimi i ekraneve të cilësimeve
27 [Software Update] (Përditësimi i softuerit)
27 [Screen Settings] (Cilësimet e ekranit)
29 [Audio Settings] (Cilësimet e audios)
29 [BD/DVD Viewing Settings] (Cilësimet e pamjes BD/DVD)
30 [Parental Control Settings] (Cilësimet e kontrollit prindëror)
30 [System Settings] (Cilësimet e sistemit)
32 [Network Settings] (Cilësimet e rrjetit)
33 [Easy Network Settings] (Cilësimet e lehta të rrjetit)
33 [Resetting] (Rivendosja)

Informacioni shtesë

34 Zgjidhja e problemeve
38 Specifikimet

Udhëzuesi i pjesëve dhe i komandave

Paneli i përparmë



1 **Sirtari i diskut**

2 **⏏ (hap/mbyll)**

3 **I/⏻ (ndezur/në gatishmëri)**
Ndez luajtësin ose e cakton në modalitet gatishmërie.

4 **Foleja ⭠ (USB)**
Lidhni një pajisje USB në këtë fole.

5 **Treguesi i energjisë**
Ndizet kur luajtësi ndizet.

6 **Sensori i telekomandës**

Për të kyçur sirtarin e diskut (Kyçja për fëmijët)

Sirtarin e diskut mund ta kyçni për të shmangur hapjen aksidentale. Kur është ndezur luajtësi, shtypni ■ (ndal), HOME dhe më pas butonin TOP MENU në telekomandë për të kyçur ose shkyçur sirtarin.

Paneli i pasmë



1 **Foleja DC IN 12 V (hyrja e ushqyesit)**

2 **Terminali LAN (100)**

3 **Foleja HDMI OUT**

4 **Foleja DIGITAL OUT (COAXIAL)**

Telekomanda

Funksionet e disponueshme të telekomandës ndryshojnë në varësi të diskut ose të situatës.



Butonat ►, ◿ + dhe AUDIO kanë një pikë të prekshme. Përdoreni pikën e prekshme si referencë kur përdorni luajtësin.

1 **⏏ (hap/mbyll)**
Hap ose mbyll sirtarin e diskut.

-TV- ⇥ (Zgjedhja e hyrjes TV)
Ndërron hyrjen midis TV dhe burimeve të tjera.

-TV- I/⏻ (TV ndezur/ në gatishmëri)
Ndez televizorin ose e cakton në modalitet gatishmërie.

I/⏻ (ndezur/në gatishmëri)
Ndez luajtësin ose e cakton në modalitet gatishmërie.

2 **Butonat me ngjyra (e kuqe/ e gjelbër/e verdhë/blu)**
Tastet e shpejta për funksione ndërvepruese.

3 **TOP MENU**
Hap ose mbyll menynë kryesore të BD-së ose DVD-së.

POP UP/MENU
Hap ose mbyll menynë kërcyese të BD-ROM ose menynë e DVD-së.

OPTIONS (faqe 23)
Shfaq opsionet e disponueshme në ekran.

RETURN
Kthehet në ekranin e mëparshëm.

←/↑/↓/→
Lëviz theksimin për të zgjedhur artikullin e shfaqur.

↑/↓ si buton shkurtore për kërkimin e këngëve gjatë riprodhimit të CD-ve muzikore.

Butoni i qendrës (ENTER)
Fut artikullin e zgjedhur.

HOME
Hyn në menynë bazë të luajtësit. Shfaq foton e sfondit kur shtypet në ikonën e kategorisë në menynë bazë.

SEN (faqe 20)
Hyn në shërbimin e internetit të „Sony Entertainment Network™".

NETFLIX
Akseson shërbimin online „NETFLIX". Për detaje të mëtejshme mbi shërbimin online NETFLIX, vizitoni faqen e mëposhtme të internetit dhe kontrolloni PESh: http://support.sony-europe.com/

4 **◀◀/▶▶ (përshpejtim prapa/ përshpejtim para)**
- Përshpejton prapa/përpara kur shtypet butoni gjatë luajtjes së diskut. Shpejtësia e kërkimit ndryshon çdo herë që shtypni butonin gjatë luajtjes së videos.
- Luan me lëvizje të ngadaltë kur shtypet për mbi një sekondë në modalitet pushimi.
- Luan një kuadër çdo herë që shtypni për pak kohë në modalitet pushimi.

▶ (luaj)
Nis ose rinis luajtjen.

|◀◀ /▶▶| (e mëparshme/tjetër)
Kapërcen në kapitullin, pjesën apo skedarin para/pas.

❚❚ (pauzë)
Vendos në pauzë ose rinis riprodhimin.

■ (ndal)
Ndalon riprodhimin dhe ruan në kujtesë pikën e ndalimit (pikën e rifillimit).
Pika e rifillimit për një titull/këngë është pika e fundit që keni luajtur ose fotoja e fundit për një dosje fotosh.

SUBTITLE (faqe 30)
Zgjedh gjuhën e titrave kur ka titra shumëgjuhëshe të regjistruara në BD-ROM/DVD VIDEO.

◿ (volumi) +/–
Rregullon volumin e televizorit.

AUDIO (faqe 29)
Zgjedh gjuhën audio kur ka shumë të tilla të regjistruara në BD-ROM/ DVD VIDEO.
Zgjedh pjesën audio në CD.

🔇 (heshtja)
Mbyll përkohësisht zërin.

DISPLAY (faqe 19)
Shfaq në ekran informacionin e luajtjes (vetëm BDP-S3200/S4200/ S5200) dhe të shfletimit në internet.

Shfaqja e menysë bazë

Menyja bazë shfaqet kur shtypni HOME. Zgjidhni një kategori me anë të ←/→. Zgjidhni një artikull me anë të ↑/↓ dhe shtypni ENTER.



[Setup] (Konfigurimi): Rregullon cilësimet e luajtësit.
[Photo] (Foto): Shfaq foto.
[Music] (Muzikë): Luan muzikë.
[Video]: Luan video.
[Input] (Hyrje): Kryen Pasqyrim të ekranit me pajisjen burimore të përputhshme (vetëm BDP-S3200/ S5200).
[Network] (Rrjeti): Shfaq artikuj nga rrjeti.

Hapi 1: Lidhja e luajtësit

Mos e vendosni kordonin elektrik në prizë pa bërë më parë lidhjet e tjera.

Lidhja me televizorin

Lidheni luajtësin me televizorin tuaj duke përdorur një kabllo HDMI me shpejtësi të lartë.





Lidhja me amplifikatorin tuaj AV (marrësin)

Zgjidhni një nga mënyrat e mëposhtme të lidhjes sipas foleve të hyrjes në amplifikatorin AV (marrës). Kur zgjidhni A ose B, bëni konfigurimet e nevojshme në [Audio Settings] (Cilësimet audio) (faqe 29).





Hapi 2: Përgatitja për lidhjen me rrjetin

Nëse nuk do ta lidhni luajtësin me rrjetin, vijoni me „Hapi 3: Easy Setup (Konfigurimi i lehtë)“ (faqe 16) .

Wired Setup

Përdorni kabllo LAN për t'u lidhur me terminalin LAN (100) në luajtës.



Rekomandojmë që të përdorni një kabllo të veshur dhe të drejtpërdrejtë (kabllo LAN).

Wireless Setup (Konfigurimi me valë) (vetëm BDP-S3200/S5200)

Përdorni LAN-in me valë që është i integruar në luajtës.



Hapi 3: Easy Setup (Konfigurimi i lehtë)

Kur ndizet për herë të parë
Prisni për pak çaste përpara se luajtësi të ndizet dhe të fillojë [Easy Initial Settings] (Cilësimet e lehta fillestare).

1 **Futni dy bateri R03 (madhësi AAA) sipas poleve ⊕ dhe ⊖ të baterive dhe shenjave brenda folesë së baterive në telekomandë.**



2 **Lidhni ushqyesin e dhënë dhe kordonin elektrik (dalja e korrentit) në rendin numerik të treguar më poshtë. Kur i hiqni, bëjeni këtë sipas rendit të kundërt.**



3 Shtypni I/⏻ për të ndezur luajtësin.



4 Ndizni televizorin dhe caktoni zgjedhësin e hyrjes në televizor. Kjo do të nxjerrë sinjalin nga luajtësi në ekranin e televizorit.

5 Kryeni [Easy Initial Settings] (Cilësimet e lehta fillestare).
Ndiqni udhëzimet në ekran për të konfigurimin bazë me anë të ←/↑/↓/→ dhe ENTER në telekomandë.



- Kur të përfundojë [Easy Initial Settings] (Cilësimet e lehta fillestare) zgjidhni [Easy Network Settings] (Cilësimet e lehta të rrjetit) për të përdorur funksionet e rrjetit të luajtësit.
- Për të aktivizuar lidhjen me valë, vendosni [Internet Settings] (Cilësimet e internetit) te [Network Settings] (Cilësimet e rrjetit) në [Wireless Setup(built-in)] (Konfigurimi me valë (i integruar)) (vetëm BDP-S3200/S5200).
- Për të çaktivizuar lidhjen me valë, vendosni [Internet Settings] (Cilësimet e internetit) te [Network Settings] (Cilësimet e rrjetit) në [Wired Setup] (Konfigurimi me tela) (vetëm BDP-S3200/S5200).

Luajtja e një disku

Për disqet që mund të luhen shihni faqe 39.

1 Ndryshoni përzgjedhësin e hyrjes në televizor që të dalë sinjali i luajtësit në ekran.

2 Shtypni ⏏ dhe vendosni diskun në sirtar.



3 Shtypni ⏏ për të mbyllur sirtarin e diskut.

Riprodhimi fillon.
Nëse luajtja nuk fillon automatikisht, zgjidhni ● në kategorinë [Video], [Music] (Muzikë), ose [Photo] (Foto) dhe shtypni ENTER.

Shikimi i BONUSVIEW/BD-LIVE

Disa BD-ROM me logon „BD-LIVE“* kanë përmbajtje bonus dhe të dhëna të tjera që mund të shkarkohen sipas dëshirës.

* BD LIVE™

1 Lidhni memorie USB në folenë USB të luajtësit (faqe 10).

Përdorni memorie USB 1 GB e lart për ruajtje lokale.

2 Përgatituni për BD-LIVE (vetëm BD-LIVE).

- Lidheni luajtësin në një rrjet (faqe 16).
- Caktoni [BD Internet Connection] (Lidhja BD me internetin) në konfigurimin [BD/DVD Viewing Settings] (Cilësimet e shikimit të BD/DVD) në [Allow] (Lejo) (faqe 30).

3 Vendosni një BD-ROM me BONUSVIEW/BD-LIVE.

Mënyra e përdorimit ndryshon në varësi të diskut. Referojuni manualit të udhëzimeve të dhënë me diskun.

Për të fshirë të dhënat në memorien USB, zgjidhni [Delete BD Data] (Fshi të dhënat BD) te kategoria [Video] dhe shtypni ENTER. Të gjitha të dhënat e ruajtura në dosjen buda do të fshihen.

Shijimi i Blu-ray 3D (vetëm BDP-S4200/S5200)

Ju mund të shijoni Blu-ray 3D Disc me logon „Blu-ray 3D“*.

* Blu-ray 3D™

1 Përgatiteni për luajtjen e Blu-ray 3D Disc.

- Lidheni luajtësin me pajisjet tuaja të përshtatshme me 3D duke përdorur një kabllo HDMI me shpejtësi të lartë.
- Caktoni [3D Output Setting] (Cilësimi i daljes 3D) dhe [TV Screen Size Setting for 3D] (Cilësimi i përmasës së ekranit të televizorit për 3D) në konfigurimin e [Screen Settings] (Cilësimet e ekranit) (faqe 27).

2 Vendosni një Blu-ray 3D Disc.

Mënyra e përdorimit ndryshon në varësi të diskut. Referojuni manualit të udhëzimeve të dhënë me diskun.

Referojuni gjithashtu manualeve të udhëzimeve të dhëna me televizorin dhe pajisjen e lidhur.

Shfaqja e informacionit të luajtjes

Ju mund të shihni informacionin e luajtjes, etj. duke shtypur DISPLAY. Informacioni i shfaqur ndryshon në varësi të llojit të diskut dhe statusit të luajtësit.

Shembull: kur luani një BD-ROM



1 Rezolucioni i daljes/Frekuenca video

2 Numri ose emri i titullit

3 Këndi i zgjedhur aktualisht

4 Cilësimi i zgjedhur aktualisht audio

5 Funksionet e disponueshme (këndi, audioja, titrat)

6 Informacioni i riprodhimit
Shfaq modalitetin e luajtjes, shiritin e statusit të luajtjes, llojin e diskut, kodekun e videos, shpejtësinë e bitëve, llojin e përsëritjes, kohën e kapërcyer, kohën totale të luajtjes.

7 Numri i kapitullit

Luajtja nga një pajisje USB

Për „Llojet e skedarëve që mund të luhen“, shihni faqe 40.

1 **Lidhni pajisjen USB në folenë USB të luajtësit (faqe 10).**
Referojuni manualit të udhëzimeve të dhënë me pajisjen USB përpara lidhjes.

2 **Zgjidhni kategorinë [Video], [Music] (Muzikë) ose [Photo] (Foto) te menyja kryesore duke përdorur ←/→.**

3 **Zgjidhni [USB device] (Pajisja USB) duke përdorur ↑/↓ dhe shtypni ENTER.**

Luajtja përmes një rrjeti

Shijimi i Sony Entertainment Network

Sony Entertainment Network shërben si portëkalim që ju ofron përmbajtjen e zgjedhur nga interneti dhe një shumëllojshmëri argëtimi sipas kërkesës direkt në luajtësin tuaj.

- Disa përmbajtje interneti kërkojnë regjistrim përmes një kompjuteri përpara se të luhen.
- Disa përmbajtje interneti mund të mos jenë të disponueshme në disa rajone/vende.

1 **Lidheni luajtësin në një rrjet (faqe 16).**

2 **Shtypni butonin SEN në telekomandë.**

3 **Zgjidhni një përmbajtje interneti dhe një shumëllojshmëri argëtimi sipas kërkesës duke përdorur ←/↑/↓/→ dhe shtypni ENTER.**

Paneli i kontrollit për transmetimin video

Paneli i kontrollit shfaqet kur skedari video fillon të luhet. Artikujt e shfaqur mund të ndryshojnë në varësi të ofruesve të përmbajtjes nga interneti.
Për t'i shfaqur sërish, shtypni DISPLAY.



1 Ekrani i kontrollit
Shtypni ←/↑/↓/→ ose ENTER për përdorimin e riprodhimit.

2 Shiriti i statusit të luajtjes
Shiriti i statusit, kursori që tregon pozicionin aktual, koha e luajtjes, kohëzgjatja e skedarit video

3 Gjendja e rrjetit
tregon fuqinë e sinjalit për lidhjen me valë (vetëm BDP-S3200/S5200).
tregon lidhjen me kabllo.

4 Shpejtësia e transmetimit të rrjeti

5 Emri i skedarit të videos tjetër

6 Emri i skedarit të zgjedhjes së videos aktuale

Luajtja e skedarëve në një rrjet shtëpie (DLNA) (vetëm BDP-S3200/S4200/S5200)

Një produkt i përshtatshëm për DLNA mund të luajë skedarë video/muzikorë/foto të ruajtura në një produkt tjetër të përshtatshëm për DLNA nëpërmjet një rrjeti.

1 Përgatiteni për të përdorur DLNA.

- Lidheni luajtësin në një rrjet (faqe 16).
- Përgatitni produktet e tjera të nevojshme të përshtatshme me DLNA. Referojuni manualit të udhëzimeve të dhënë me produktin.

Për të luajtur një skedar nga një server DLNA nëpërmjet kësaj njësie (luajtësi DLNA)



Zgjidhni ikonën e serverit DLNA nga kategoria [Video], [Music] (Muzikë), ose [Photo] (Foto) pastaj zgjidhni skedarin që dëshironi të luani.

Për të luajtur një skedar nga një server DLNA nëpërmjet një produkti tjetër (renderuesi)

Kur luani skedarë nga një server DLNA në këtë njësi, mund të përdorni një produkt të përshtatshëm për kontrolluesin DLNA (një telefon, etj.), për të kontrolluar riprodhimin.



Kontrolloni këtë njësi duke përdorur një kontrollues DLNA. Referojuni manualit të udhëzimeve të dhënë me kontrolluesin DLNA.

Përdorimi i „TV SideView“ (vetëm BDP-S3200/S4200/S5200)

„TV SideView“ është një aplikacion falas për pajisjet në distancë (si p.sh. telefonat smartphone, etj.). Duke përdorur „TV SideView“ me këtë luajtës, mund të shijoni me lehtësi luajtësin duke përdorur pajisjen në distancë. Ju mund të nisni një shërbim apo aplikacion direkt nga pajisja në distancë dhe të shikoni informacionin e diskut gjatë riprodhimit të diskut. „TV SideView“ mund të përdoret gjithashtu si telekomandë dhe tastierë për softuerin.
Përpara se ta përdorni pajisjen „TV SideView“ për herë të parë me këtë luajtës, sigurohuni që ta regjistroni pajisjen „TV SideView“. Ndiqni udhëzimet e shfaqura në ekranin e pajisjes „TV SideView“ për regjistrimin.

Regjistrimi mund të kryhet vetëm në Ekranin e menysë bazë.

Përdorimi i pasqyrimit të ekranit (vetëm BDP-S3200/S5200)

„Screen mirroring“ është një funksion për të shfaqur ekranin e një pajisjeje celulare në televizor përmes teknologjisë Miracast.
Luajtësi mund të jetë lidhur direkt me një pajisje të përputhshme për pasqyrimin e ekranit (p.sh. telefon smartphone, tabletë). Ju mund të shijoni ekranin e pajisjes në ekranin e madh të televizorit tuaj. Për të përdorur këtë veçori nuk kërkohet asnjë ruter me valë (ose pikë aksesi).

- Kur përdorni Pasqyrimin e ekranit, cilësia e figurës dhe e zërit mund të përkeqësohet ndonjëherë për shkak të interferencave nga rrjetet e tjera.
- Disa funksione rrjeti mund të mos jenë të disponueshme gjatë Pasqyrimit të ekranit.
- Sigurohuni që pajisja të jetë e përputhshme me Miracast. Nuk garantohet lidhja me të gjitha pajisjet e përputhshme Miracast.

1 **Zgjidhni [Screen mirroring] (Pasqyrimi në ekran) nga kategoria [Input] (Hyrja) në menynë kryesore duke përdorur ←/→ dhe shtypni ENTER.**

2 **Ndiqini udhëzimet në ekran.**

Opsionet e disponueshme

Përdorime të riprodhimit dhe cilësime të ndryshme bëhen të disponueshme duke shtypur OPTIONS. Artikujt e disponueshëm ndryshojnë në varësi të situatës.

Opsionet e zakonshme

- **[Repeat Setting] (Përsërit cilësimin):** Vendos modalitetin e përsëritjes.
- **[3D Menu] (Menyja 3D) (vetëm BDP-S4200/S5200):**
  - [Simulated 3D] (3D e simuluar): Përshtat efektin e simuluar 3D
  - [3D Depth Adjustment] (Rregullimi i thellësisë 3D): Përshtat thellësinë e imazhit 3D
  - [2D Playback] (Riprodhimi 2D): Vendos riprodhimin e imazhit 2D.
- **[Play]/[Stop] (Luaj/Ndalo):** Nis ose ndalon riprodhimin.
- **[Play from start] (Luaj nga fillimi):** Luan artikullin nga fillimi.
- **[Change Category] (Ndrysho kategorinë):** Ndryshon kategoritë ndërmjet [Video], [Music] (Muzikë) dhe [Photo] (Foto).

Vetëm [Video]

- **[A/V SYNC] (Sinkronizimi A/V):** Rregullon vonesën mes figurës dhe zërit, duke vonuar daljen e zërit sipas daljes së figurës (0 deri 120 milisekonda).
- **[Video Settings] (Cilësimet e videos):**
  - [Picture Quality Mode] (Modaliteti i cilësisë së figurës): Zgjedh cilësimet e figurës për mjedise me ndriçime të ndryshme.
  - [BNR]: Redukton „mizat“ e blloqeve në formë mozaiku në figurë.
  - [MNR]: Redukton „mizat“ e vogla rreth kontureve të figurës.
- **[Pause] (Pauzë):** Vendos në pauzë riprodhimin.
- **[Top Menu] (Menyja e sipërme):** Shfaq menynë kryesore të BD-së ose DVD-së.
- **[Menu] (Menyja)/[Popup Menu] (Menyja kërcyese):** Shfaq menynë kërcyese të BD-ROM ose menynë e DVD.
- **[Title Search] (Kërkimi i titujve):** Kërkon një titull në BD-ROM/ DVD VIDEO dhe fillon riprodhimin nga fillimi.
- **[Chapter Search] (Kërkimi i kapitujve):** Kërkon një kapitull dhe nis riprodhimin nga fillimi.
- **[Audio]:** Ndryshon gjuhën audio kur ka shumë të tilla të regjistruara në BD-ROM/DVD VIDEO. Zgjedh pjesën audio në CD.
- **[Subtitle] (Titrat):** Ndërron gjuhën e titrave kur ka titra shumëgjuhëshe të regjistruara në BD-ROM/ DVD VIDEO.
- **[Angle] (Këndi):** Kalon në kënde të tjera shikimi kur në BD-ROM/DVD VIDEO janë regjistruar disa kënde.
- **[Number Entry] (Hyrja e numrave):** Zgjedh numrin duke përdorur butonin ←/↑/↓/→ në telekomandë.
- **[IP Content Noise Reduction] (Reduktimi i zhurmës së përmbajtjes IP):** Përshtat cilësinë e figurës së përmbajtjeve të internetit.
- **[Video Search] (Kërkimi për video) (vetëm BDP-S3200/S4200/S5200):** Shfaq informacionin në BD-ROM/ DVD-ROM bazuar në teknologjinë Gracenote.
  Kërkon për informacione të përafërta duke përdorur fjalë kyçe nga Gracenote kur zgjidhet [Cast] (Kasti) ose [Related] (Të lidhura).
  Afishon një listë me tituj kur zgjidhet [Playback History] (Historiku i riprodhimit) ose [Search History] (Historiku i kërkimit).

Vetëm ♫ [Music] (Muzikë)

- **[Track Search] (Kërkimi i pjesëve):** Kërkon numrin e pjesës gjatë riprodhimit të CD-ve muzikore.
- **[Add Slideshow BGM] (Shto shfaqje rrëshqitëse BGM):** Regjistron skedarë muzikorë në memorien USB si shfaqje rrëshqitëse me muzikë sfondi (BGM).
- **[Music Search] (Kërkimi për muzikë) (vetëm BDP-S3200/S4200/S5200):** Shfaq informacionin në CD audio (CD-DA) bazuar në teknologjinë Gracenote.
  Kërkon për informacione të përafërta duke përdorur fjalë kyçe nga Gracenote kur zgjidhet [Track] (Pjesa), [Artist] (Artisti) ose [Related] (Të lidhura).
  Afishon një listë me tituj kur zgjidhet [Playback History] (Historiku i riprodhimit) ose [Search History] (Historiku i kërkimit).

Vetëm 📷 [Photo] (Foto)

- **[Slideshow Speed] (Shpejtësia e shfaqjes rrëshqitëse):** Ndryshon shpejtësinë e shfaqjes rrëshqitëse.
- **[Slideshow Effect] (Efekti i shfaqjes rrëshqitëse):** Vendos efektin për shfaqjet rrëshqitëse.
- **[Slideshow BGM] (BGM e shfaqjes rrëshqitëse):**
  – [Off] (Joaktiv): Fik funksionin.
  – [My Music from USB] (Muzika ime nga USB): Vendos skedarët muzikorë të regjistruar në [Add Slideshow BGM] (Shto BGM të shfaqjes rrëshqitëse) (Shto shfaqje rrëshqitëse me muzikë sfondi).
  – [Play from Music CD] (Luaj nga CD muzikore): Vendos këngët në CD-DA.
- **[Change Display] (Ndrysho ekranin):** Kalon ndërmjet [Grid View] (Pamje tabelë) dhe [List View] (Pamje listë).
- **[View Image] (Shfaq imazhin):** Shfaq foton e zgjedhur.
- **[Slideshow] (Shfaqje rrëshqitëse):** Luan një shfaqje rrëshqitëse.
- **[Rotate Left] (Rrotullo majtas):** Rrotullon foton në drejtim të kundër të akrepave të orës me 90 gradë.
- **[Rotate Right] (Rrotullo djathtas):** Rrotullon foton në drejtim të akrepave të orës me 90 gradë.

Internet (vetëm BDP-S3200/S4200/S5200)

Shfletimi i faqeve të internetit

Ju mund të lidheni me internetin dhe të shijoni faqet e internetit.

1 **Përgatiteni shfletuesin e internetit.**
Lidheni luajtësin në një rrjet (faqe 16).

2 **Zgjidhni [Network] (Rrjeti) në menynë kryesore duke përdorur ←/→.**

3 **Zgjidhni [Internet Browser] (Shfletuesi i internetit) duke përdorur ↑/↓ dhe shtypni ENTER.**

Ky shfletues nuk i mbështet funksionet e disa faqeve të internetit dhe disa faqe mund të mos shfaqen siç duhet.

Për të vendosur një URL

Zgjidhni [URL entry] (Hyrje URL) nga menyja e opsioneve. Vendosni URL duke përdorur tastierën e softuerit, më pas zgjidhni [Enter] (Hyrje).

Për të vendosur faqen e parazgjedhur të nisjes

Gjatë afishimit të faqes që dëshironi të vendosni, zgjidhni [Set as start page] (Vendos si faqe nisjeje) nga menyja e opsioneve.

Për t'u kthyer në faqen e mëparshme

Zgjidhni [Previous page] (Faqja e mëparshme) nga menyja e opsioneve. Kur faqja e mëparshme nuk shfaqet edhe nëse zgjidhni [Previous page] (Faqja e mëparshme), zgjidhni [Window List] (Lista e dritareve) nga menyja e opsioneve dhe zgjidhni faqen tek e cila dëshironi të ktheheni nga lista.

Për të mbyllur shfletuesin e internetit

Shtypni HOME.

Ekrani i shfletuesit të internetit

Ju mund të kontrolloni informacionin e uebsajtit duke shtypur DISPLAY. Informacioni i shfaqur ndryshon në varësi të llojit të uebsajtit dhe statusit të faqes.



1 Titulli i faqes

2 Adresa e faqes

3 Kursori
Lëvizni duke shtypur ←/↑/↓/→. Vendosni kursorin në lidhjen që dëshironi të shikoni, më pas shtypni ENTER. Shfaqet uebsajti i lidhur.

4 Ikona SSL
Tregon kur një faqe interneti është e mbrojtur dhe e lidhur me siguri.

5 Treguesi i fuqisë së sinjalit (vetëm për lidhje me valë) (vetëm BDP-S3200/S5200)

6 Shiriti i progresit/Ikona e ngarkimit
Shfaqet kur faqja është duke u lexuar, ose gjatë shkarkimit/transferimit të skedarëve.

7 Fusha e futjes së tekstit
Shtypni ENTER dhe zgjidhni [Input] (Futje) nga menyja e opsioneve për të afishuar tastierën e softuerit.

8 Shiriti i lëvizjes
Shtypni ←/↑/↓/→ për ta lëvizur afishimin e faqes majtas, lart, poshtë ose djathtas.

Opsionet e disponueshme

Përdorime dhe cilësime të ndryshme bëhen të disponueshme duke shtypur OPTIONS.
Artikujt e disponueshëm ndryshojnë në varësi të situatës.

- **[Browser Setup] (Konfigurimi i shfletuesit):** Shfaq cilësimet e shfletuesit të internetit.
  - [Zoom] (Zmadhimi): Ul ose rrit përmasën e përmbajtjes së shfaqur.
  - [JavaScript Setup] (Konfigurimi i JavaScript): Aktivizon ose çaktivizon JavaScript.
  - [Cookie Setup] (Konfigurimi i kukive): Vendos nëse pranohen apo jo kukit.
  - [SSL Alarm Display] (Ekrani i alarmit SSL): Aktivizon ose çaktivizon SSL.
- **[Input] (Hyrje):** Shfaq tastierën e softuerit për të vendosur karakteret gjatë shfletimit të një uebsajti.
